



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.06, datë 31.07.2024

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“NDËRTIMI I STALLËS DHE INFRASTRUKTURËS BAZË PËR LABORATORËT
PRODHUES E DIDAKTIKE NË SHKOLLËN E MESME BUJQËSORE “RAKIP
KRYEZIU”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË FIER”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues Ministrisë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i stallës dhe infrastrukturës bazë për laboratorët prodhues e didaktike në Shkollën e Mesme Bujqësore “Rakip Kryeziu”, me vendndodhje në Bashkinë Fier”, me subjekt zhvillues Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Fier.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.


KRYETARI
EDI RAMA



MINISTER I LINJËS
MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
BLENDI GONXHIA



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 23 / 10 / 2024